

# Ndikimi i politikëbërësve në punën kërkimore shkencore në Kosovë

Tryezë: Maj 2013

Më 20 maj 2012, Qendra për Kurajo Politike (CPC) përmes Programit për Promovimin e Hulumtimeve Rajonale në Ballkanin Perëndimor (RRPP) dhe në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës (UP), organizoi tryezën e rrumbullakët me temë *Ndikimi i politikëbërësve në punën kërkimore shkencore në Kosovë*. Tryeza kishte qëllim të dyfishtë: Të informoj hisedarët relevantë që merren me politikën e arsimit të lartë në Kosovë, përfshirë këtu Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Komisionin për Arsim, Kulturë, Rinë, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media të Kuvendit të Kosovës (tutje Komisioni për Arsim) rreth gjendjes së tanishme të hulumtimeve shkencore në Kosovë dhe me të gjeturat e raportit me titull *Hulumtimi në Shkenca Shoqërore në Kosovë*, të publikuar nga CPC në shkurt të vitit 2013. Paralelisht kësaj, tryeza kishte për qëllim të avokoj tek institucionet që dizajnojnë politikën e arsimit të lartë dhe politikën e kërkimeve shkencore për avancimin e kornizës ligjore që rregullon kërkimet shkencore dhe autonominë financiare të institucioneve kërkimore në Kosovë dhe rritjen e implementueshmërisë së këtij legjislacioni.

Panelist të kësaj tryeze ishin: z. Adem Beha, Koordinator i Grupit për Avokim nga CPC dhe ligjërues në Departamentin e Shkencës Politike, z. Arben Hajrullahu, profesor në Departamentin e Shkencës Politike, z. Murteza Osdautaj, Drejtor për Shkencë dhe Teknologji në MASHT, znj. Teuta Haxhiu, z. Afrim Kasolli dhe znj. Lirie Kajtazi që të tre anëtarë të Komisionit për Arsim dhe z. Bujar Dugolli, Dekan i Fakultetit Filozofik. Rreth 25 hulumtues, profesorë universiteti, vendimmarrës, përfaqësues të Rektoratit të UP-së, përfaqësues të think-tank-ve përballën idetë dhe vlerësimet e tyre për avancimin e kërkimeve shkencore në Kosovë.

Gjatë diskutimeve në tryezë u vlerësua si e domosdoshme të mbështeten hulumtimet shkencore në Kosovë. Dokumentet bazë të prezentuara në tryezë ishin *Hulumtimi në Shkenca Shoqërore në Kosovë*, raport i botuar nga CPC, *Plani Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës*, strategji e aprovuar nga MASHT dhe *Ligji për Veprimtari Kërkimore dhe Shkencore*. Diskutimet e panelistëve dhe pjesëmarrësve janë reflektuar në pjesët vijuese të këtij raporti.

## Shkenca dhe ekonomia

Gjatë hapjes dhe prezantimit hyrës z. Adem Beha dhe z. Arben Hajrullahu pasi paraqitën rekomandimet e bëra për MASHT-in dhe Kuvendine Kosovës në raportin *Hulumtiminë Shkencat Shoqërore në Kosovë*, argumentuan edhe rreth rëndësisë së investimeve në shkencë. Është vërtetuar empirikisht se shtetet që kanë bërë investime të mjaftueshme në kërkime dhe shkencë kanë rritur GDP-të e tyre dhe kanë avancuar standardin e jetës dhe mirëqenien publike të vendeve të tyre. Investimi për shkencën në Kosovë është i pamjaftueshëm dhe ende mungojnë politika stimuluese për përkrahjen e kërkimeve shkencore.

## Programi Kombëtar i Shkencës në Republikën e Kosovës

Këshilli Kombëtar i Shkencës, më 30 mars 2010, miratoi *Programin Kombëtar të Shkencës së Republikës së Kosovës* (tutje Programi). Programi në përputhje me *Ligjin për Veprimtari Kërkimore Shkencore nr. 2004/42*, ka për qëllim identifikimin e prioritetëve shkencore, forcimin e pjesëmarrjes së Kosovës në projekte ndërkombëtare kërkimore-shkencore dhe krijimin e kushteve për investime në infrastrukturë.<sup>1</sup> Programi jep një pasqyrë për arsyet e mungesës së kërkimeve shkencore në Kosovë, përfshirë këtu përjashtimin e komunitetit akademik nga kërkimi shkencor në vitet 90, izolimin e këtij komuniteti nga zhvillimet ndërkombëtare pas 1999 dhe mungesën e zhvillimit ekonomik, dhe si pasojë e të gjithë këtyre faktorëve edhe mungesën e kapaciteteve absorbuese për të aplikuar në projekte ndërkombëtare. Në Program theksohet se investimet për shkencë dhe kërkime në Kosovë janë nën mesataren evropiane me rreth 0.1% të GDP-së së Kosovës.

Në Program janë vendosur pesë objektiva për zhvillim e kërkimit shkencor si në vijim: a) Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për veprimtari kërkimore-shkencore; b) Zhvillimi i infrastrukturës kërkimore shkencore; c) Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore; d) Forcimi i lidhjeve midis shkencës, shoqërisë dhe ekonomisë për nxitur zhvillimin ekonomik dhe shoqëror; e) Përsosmëri në veprimtarinë kërkimore-shkencore. Grupi i ekspertëve që ka hartuar Programin, nga 33 fusha potenciale të hulumtimit, ka ngushtuar listën e prioritetëve në 5, të cilat janë: a) Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi; b) Prodhimi bujqësor dhe siguria e ushqimit; c) Kërkimet shkencore në mjekësi; d) Studimet shoqërore dhe ekonomike; dhe e) Studimet gjuhësore, kulturore dhe historike.<sup>2</sup> Në Program theksohet se “sistemi i arsimit të lartë në Kosovë është i periudhës para Humboldtit dhe karakterizohet me marginalizimin e kërkimeve shkencore. Kjo diagnozë vlen për tërë sektorin, përfshirë këtu edhe Universitetin e Mitrovicës dhe Universitetin e Prishtinës, i cili është edhe institucioni më i madh në Kosovë i orientuar në hulumtime shkencore”.<sup>3</sup> Për të përmirësuar këtë gjendje, në përputhje me pesë objektivat e renditura më lartë, në Program janë propozuar masa konkrete. Sidoqoftë, këto masa mbeten vetëm pjesërisht të realizuara.

Z. Murteza Osdautaj pasi prezantoi Programin, theksoi se aty është paraparë edhe buxheti për realizimin e prioritetëve të tij, i cili buxhet nuk është ndarë asnjëherë ashtu siç është paraparë. Megjithatë, me buxhetin e vogël i cili është ndarë për realizimin e këtij Programi, disa prej aktivitetëve të parapara janë realizuar, si në vijim: zhvillimi i projekteve shkencore, mobiliteti i komunitetit shkencor, themelimi i shpërbimit “Shkencëtari i Vitit”, qasja në burimet elektronike etj. Z. Osdautaj tha se deri në vitin 2010 Kosova nuk pasur ndonjë buxhet të përcaktuar për shkencë. Megjithatë, më 2010, për shkak të vonesës, alokimit të këtij buxheti në fund të vitit, ai nuk arriti të shpenzohet i tëri. Në vitin 2011 dhe 2012, Qeveria e Kosovës ka ndarë € 480.000 për shkencë, kurse në vitin 2013 ka ndarë € 580.000. Përkundër këtij buxheti të ulët, sipas z. Osdautaj është vërejtur një mungesë e kapaciteteve absorbuese. Paralelisht kësaj, z. Osdautaj prezantoi dy draft dokumente të tjera: *Strategjinë Kombëtare për Inovacione dhe Strategjinë për Rajonin*, e cila mëton që vendet e rajonit të veprojnë si një trup i vetëm, marrë parasysh aftësinë e vogël konkurruese që këto vende individualisht kanë karshi zhvillimeve shkencore në botë.

Rreth *Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore*,<sup>4</sup> z. Osdautaj theksoi se MASHT në vitin 2012 ka dorëzuar një draft të këtij ligji në Kuvendin e Kosovës, i cili do të kishte rregulluar çështjen e veprimtarisë kërkimore-shkencore. Megjithatë, ky draftligj, sipas tij, është miratur me ndryshime rrënjësore, në një formë krejt tjetër dhe disa pjesë të ligjit që do të kishin rregulluar fushën e teknologjisë dhe inovacionet nuk janë të përfshira në ligjin e miratuar fare.

Z. Osdautaj përmendi shembujt e dy vendeve që Kosova do të duhej të ndiqte. Sipas tij, Koreja e Jugut dhe Izraeli, në vitet e 60-ta, në nivel të zhvillimit, janë barazuar me Kosovën. Tani, Izraeli është vendi i parë në botë që ndan rreth 4.8% të GDP-së vet për hulumtime shkencore. Në anën tjetër, Koreja e Jugut ndan rreth 3.8% të GDP-së për hulumtime shkencore, ku 47% e popullësisë së saj nga moshë 22 deri në 65 vjet janë me shkollë të lartë.

## Vendimmarrësit dhe shkenca

Znj. Teuta Haxhiu, z. Afrim Kasolli dhe znj. Lirie Kajtazi nga Komisioni për Arsim prezantuan rreth *Ligjit për Veprimtari Kërkimore Shkencore*. Znj. Teuta Haxhiu theksoi se rekomandimet e dalura nga raporti Hulumtimi në Shkencat Shoqërore në Kosovë drejtuar Kuvendit të Kosovës janë realizuar. Kështu, në ligjin aktual për Veprimtari Kërkimore Shkencore është paraparë të ndahen 0.7% e buxhetit total të Kosovës për hulumtime shkencore. Sipas znj. Haxhiu problemi nuk është vetëm miratimi

1 Shih Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës, f. 5. <http://www.uni-pr.edu/getattachment/21dfd45e-cd3e-47da-ad78-a2fe060ec1e9/Programi-Kombetar-i-Shkencës-i-Republikës-se-Kosovë.aspx> (qasur më 27 maj 2013)

2 Ibid, f. 5.

3 Ibid, f. 10.

4 Shih Ligji Nr.04/L-135 për Veprimtari Kërkimore Shkencore. <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20veprimtari%20kerkimore%20shkencore.pdf> (qasur më 27 maj 2013)

i ligjit, por edhe zbatimi i tij. Ajo adresoi procedurat vendimmarrëse dhe presionet që në ligj të thuhet se buxheti për realizimin e këtij ligji të jetë deri në 0.7%, i cili propozim nuk është përkrahur nga Komisioni për Arsim dhe në fund është aprovuar propozimi që të ndahet 0.7% e buxhetit të Kosovës për implementimin e këtij ligji.

Z. Afrim Kasolli nga Komisioni për Arsim tha se deri më tani Kuvendi i Kosovës ka miratuar disa ligje që kanë për qëllim të rregullojnë punën kërkimore-shkencore, por, sipas tij problem kryesor mbetet që ligjet, strategjitë dhe dokumentet nuk gjejnë zbatim për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Sipas tij, fjala vjen, *Programi Kombëtar i Shkencës* nuk ka gjetur zbatim të duhur dhe nuk është operacionalizuar në sferën praktike, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Përkritazi me rekomandimet e CPC-së për Kuvendin e Kosovës, i cili rekomandon miratimin e *Ligjit për Aktivitete Shkencore*, z. Kasolli tha se Kuvendi i Kosovës e ka përbushur këtë obligim dhe ka miratuar *Ligjin për Veprimtari Kërkimore Shkencore*,<sup>5</sup> i cili ligj rregullon se 0.7% e buxhetit të Kosovës do të duhej të ndahet për implementimin e këtij ligji. Sipas z. Kasolli edhe ligji i paraparak ka paraparë 0.7% të buxhetit të Kosovës për implementimin e tij, por problem më i madh është se çdo vit është një ligj, i cili është matrica e të gjitha ligjeve pra, ligji për buxhetin dhe në projektligj për buxhetin mungon operacionizimi se si do të distribuohen fondet me qëllim të avancimit të veprimtarisë shkencore. Më tutje, z. Kasolli tha se në *Ligjin për Buxhet* nuk figuron kjo ndarje e shpenzimeve për implementim e *Ligjit për Veprimtari Kërkimore Shkencore*. Problemi tjetër, sipas z. Kasolli, ka të bëjë me mungesën e vullnetit politik për të zbatuar këto ligje. Ai tha se Kosova ka një Program Kombëtar të Shkencës, por nuk ka një Këshill Kombëtar të Shkencës. Edhe pse MASHT fillimisht kishte propozuar emrat për Këshillin Kombëtar të Shkencës, ata nuk u zgjodhën kurrë, tha ai. Sipas tij, Kosova nuk ka bartës të implementimit të këtyre projekteve dhe ligjeve. Për më shumë, z. Kasolli nënvizoi se Këshilli Kombëtar i Shkencës, si organ i Kuvendit të Kosovës, është njëri prej organeve më relevante në sferën e politikëbërjes shkencore dhe ky organ nuk është i konstituar.

*Draftligji për Veprimtari Kërkimore Shkencore* kishte paraparë krijimin e një Agjencie Shtetërore për përkrahjen e shkencës. Propozimi për krijimin e këtij mekanizimi ka hasur në rezistencë të madhe si nga MASHT-i, ashtu edhe nga një numër i deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Ideja për krijimin e këtij agjencioni është bazuar në praktikën e mira të vendeve të zhvilluara. Sipas z. Kasolli, në shumë vende të ndryshme ekzistojnë Agjenci Shtetërore Shkencore të cilat shërbejnë si ndërlikje ndërmjet Komisionit Evropian dhe hulumtuesve vendor, që kanë qëllim të thithjeve të fondeve për shkencë nga Komisioni Evropian. Ky propozim nuk është përfshirë në ligjin e ri për shkak të presionit, mungesës së një linje të veçantë buxhetore për funksionalizimin e tij dhe në vend të tij është propozuar krijimin i një agjencie qeveritare në kuadër të MASHT-it. Megjithatë, sipas z. Kasolli nevoja për krijimin e Agjencionit Shtetëror të Shkencës mbetet imediate.

## Rreth problemeve të kërkimeve shkencore

Z. Arben Hajrullahu tha se nëse *Ligji për Veprimtari Kërkimore Shkencore* parasheh 0.7% të buxhetit total të Kosovës për implementimin e tij dhe nëse kjo nuk është e obligueshme për *Ligjin e Buxhetit*, kjo prodhon situatë jo ligjore. Ligjet që miratohen nga Kuvendi i Kosovës, shtoi ai, duhet ta obligojnë projektbuxhetin për ndarjen e mjeteve të parapara me ligj për implementimin e tyre.

Z. Osdautaj theksoi se nuk është praktikë parlamentare e vendeve të zhvilluara që ligji të ndryshohet në atë masë sa është ndryshuar në Kuvendin e Kosovës.

Znj. Hasnjije Ilazi, profesoreshë në Departamentin e Filozofisë në UP, e vlerësoi gadishmërinë e Komisionit për Arsim dhe Drejtorinë për Shkencë në MASHT për t'i dëgjuar nevojat e hulumtuesve shkencor në Kosovë. Znj. Ilazi theksoi se vërejtja kryesore e stafit akademik ka qenë mospërfshirja e tyre në proceset e hartimit të legjislationit primar dhe atij sekondar. Duke mos qenë të përfshirë në këtë proces të ligjvënës, profesorët e kanë të vështirë që të avokojnë për ato çështje që janë të rëndësishme për rregullimin e kërkimeve shkencore në Kosovë. Lidhur me Agjencinë për Shkencë, znj. Ilazi tha se me këtë agjencion kemi dyfishim të mekanizmave për shkak se të njëjtat kompetencat që do t'i ushtrij ky agjencion i ushtron Departamenti për Shkencë i MASHT-it.

Z. Nuri Bashota, anëtar i Këshillit Kombëtar për Shkencë në MASHT, theksoi se një prej problemeve kryesore të arsimit të lartë që mbetet për t'u adresuar është depolitizimi i arsimit dhe shkencës. MASHT, shtoi z. Bashota ka një mori kërkesash për kërkime shkencore të cilat përzgjidhen me kujdes, por ka mungesë të financimit për shkak të politizimit të institucioneve shkencore dhe udhëheqjes së këtyre institucioneve nga militantët e partive politike.

Z. Bujar Dugolli tha se vendet në tranzicion kanë probleme të shumta, por është përgjegjësi e intelektualëve për t'i shtruar dhe adresuar ato probleme. Mbetet detyrë e ligjvënësëve, theksoi ai, që të bartet ky shqetësim që ka bota akademike nga UP rreth kërkimeve shkencore duke kërkuar ndryshimin e politikave dhe ligjeve në favor të frymarrjes së lirë të botës akademike. Fakulteti Filozofik ka bërë disa rekomandime për ndryshimin e *Ligjit për Arsimin e Lartë* dhe këto rekomandime janë dorëzuar në MASHT para dy muajve, por ende nuk kemi marrë përgjigje se çfarë ka ndodhur me këto rekomandime. Duhet të ndryshohet *Ligji për Arsimin e Lartë* dhe më pastaj Statuti i UP-së, që rregullon funksionimin e brendshëm në universitet, konkludoi z. Dugolli.

Znj. Sahadete Limani-Beqa, profesoreshë në Departamentin e Gazetarisë, tërhoqi vërejtjen se shpeshherë në procesin e

propozimit dhe ndryshimit të legjislacionit dhe politikave, nuk ftohen njerëzit kompetent që do të ndikohen nga këto politika. Lidhur me mungesën e kapaciteteve absorbuese për marrjen e fondeve të instituteve hulumtuese nga MASHT, znj. Limani-Beqa theksoi se duhet të identifikohet problemi se pse fondet e MASHT-it për shkencë dhe hulumtim nuk shfrytëzohen dhe ky problem të adresohet qoftë përmes një fushate më të mirë informuese, qoftë përmes ndryshimit të procedurave të aplikimit për marrjen e këtyre fondeve.

Znj. Lirie Kajtazi tha se përveç problemit të absorbimit të fondeve të MASHT-it, do të ishte mirë që të shihet edhe mënyra e shpenzimit të fondeve për kërkime dhe shkencë të MASHT-it e cila duhet të jetë korrekte. Znj. Kajtazi tha se UP fondin për hulumtime dhe botime e bartë në një kategori tjetër, atë të shpenzimeve.

Z. Gjon Berisha, hulumtues në Institutin e Historisë, tha se një ndër arsytet pse ka mungesë të absorbimit të fondeve për hulumtime shkencore ka të bëjë me faktin se MASHT-i më shumë i kushton rëndësi procedurave të aplikimit për fonde sesa rezultatit të punës kërkimore.

Z. Hysen Bytyqi, profesor dhe udhëheqës i Zyrës për Zhvillim Akademik në UP, tha se të gjitha palët që marrin pjesë në zingjirin e hierarkisë që merren me problematikën e arsimit të lartë duhet t'i kthehen vetëkritizimit. MASHT-i dhe UP nuk duhet të marrin rolin mbrojtës, për shkak se duke e luajtur këtë rol këto institucione nuk mund t'i shohin mangësitë e tyre, theksoi z. Bytyqi. Nevojitet një avokim më i madh për ta bindur Komisionin për Buxhet për të aprovuar buxhet më të lartë për implementimin e ligjeve për kërkime shkencore. Një nga problemet që z. Bytyqi përmendi ishte edhe cilësia e ulët dhe kapacitetet e mangëta për shkrimin e projekteve kërkimore shkencore, me të cilat aplikohet në MASHT.

## Rekomandimet

### Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media të Kuvendit të Kosovës të:

- Monitoroj në mënyrë të rregullt zbatimin e *Strategjisë Kombëtare të Shkencës, Ligjit për Veprimtari Kërkimore Shkencore* dhe *Ligjit për Arsimin e Lartë*;
- Krijoj partneritet me institucionet që merren me kërkime shkencore dhe të rritë bashkëpunimin dhe presionin tek Komisioni për Buxhet dhe Financa për ndarjen e 0.7%

të buxhetit të Kosovës për implementimin e *Ligjit për Veprimtari Kërkimore Shkencore*;

- Përfshijë komunitetin e gjerë shkencor të Kosovës në procesin e hartimit të legjislacionit që rregullon sferën e hulumtimeve shkencore në Kosovë dhe të ketë për bazë rekomandimet e tyre.

### Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës të:

- Operacionalizoj projektligjin për buxhet të vitit 2014 dhe të viteve vijuese duke garantuar që të ndahen 0.7% e buxhetit të Kosovës, me një linjë të veçantë, për zbatimin e *Ligjit për Veprimtari Kërkimore dhe Shkencore*.

### Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të:

- Riemërohet Këshilli Kombëtar i Shkencës si bartës kryesor i *Strategjisë Kombëtare të Shkencës të Republikës së Kosovës*;
- Mirëpres krijimin e Agjencionit Shtetëror për Shkencë me qëllim të ndërmjetësimit të interesave të komunitetit shkencor në Kosovë kundrejt institucioneve brenda dhe jashtë Kosovës;
- Ndërmarrë fushata të kohë pas kohëshme informuese me qëllim të shpërndarjes së informative rreth fondeve për kërkimeve shkencore;
- Thjeshtësoj procedurat për aplikim dhe marrje të fondeve për kërkime shkencore;
- Risë transparencën rreth shpenzimeve të fondeve për kërkime dhe shkencë dhe të raportoj në mënyrë të rregullt për projektet që mbështeten nga MASHT-i.

### Universiteti i Prishtinës të:

- Identifikon nenet e *Ligjit për Arsimin e Lartë* të cilat nuk janë në funksion të afirmimit të shkencës dhe hulumtimit dhe të avokohet për amendamentimin e këtyre neneve në përputhje me interesat e komunitetit shkencor në Kosovë;
- Ndryshoj Statutin e *UP-së*, në përputhje me ligjin e amendamentuar dhe të bëhet decentralizimi i veprimtarisë së *UP-së*;
- Risë autonominë dhe efikasitetin financiar për institutet kërkimore shkencore brenda *UP-së*;
- Mos bart në kategorinë e shpenzimeve buxhetin e ndarë për kërkime dhe botime;
- Risë cilësinë e projekteve shkencore me të cilat aplikohet në MASHT dhe tek donatorët e jashtëm;
- Krijoj një grup ad-hoc për të avokuar për ndryshimin e legjislacionit për shkencë dhe rrisë përfshirjen në proceset e hartimit të legjislacionit për shkencë dhe kërkime.